



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE ZHVILLIMIT

Datë: 16/12/2025

NJOFTIM PËR MOBILITET TË STUDENTËVE DHE DOKTORANTËVE TË FMV-së
Università degli Studi di Perugia – Itali

Në kuadër të projektit Erasmus+ midis Universitetit Bujqësor të Tiranës dhe Università degli Studi di Perugia në Itali, shpallet thirrja për aplikim për 4 (katër) kuota mobilitete për praktikë profesionale si dhe 2 (dy) kuota mobilitete për doktorantë.

Kush mund të aplikojë:

- Studentët e vitit të pestë të Fakultetit të Mjekësisë Veterinare;
- Doktorantë në proces studimesh në FMV.

Kohëzgjatja e qëndrimit: 3 muaj.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Curriculum Vitae (CV) në gjuhën angleze (preferohet Europass);
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Transkript zyrtar notash nga institucioni;
- Dëshmi e njohjes së gjuhës italiane (niveli A2) ose gjuhës angleze (niveli B1);
- Dokumentacion justifikues për statusin '**student me më pak mundësi**' (nëse aplikohet).

Afati i dorëzimit të dokumenteve: 05 /01 / 2026

Dokumentet duhet të dërgohen në adresat:

- erasmusoffice@ubt.edu.al
- tana.shtylla@ubt.edu.al

Për çdo informacion shtesë, ju lutem kontaktoni Zyrën Erasmus+ të UBT-së, godina B (FEA), nr. 103.